



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr 400- 22810 dt. 29.06 2020

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40, të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale nr. 03/L-040, nenit 34,pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 nr.320-19332, për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017. Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vendimit me nr12.nr.400-37743 të datës 03.07.2018 Për plotësim ndryshimin e Rregullores nr12-320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, si dhe Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2020.Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me date 29.06.2020, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT KF „DRENASI”

Neni 1.

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin e KF „Drenasi”. Lidhur me mbulimin e shpenzimeve për sezonin pranveror-vjeshtor 2020, anëtare e Ligës së Parë të Kosovës.

Neni 2.

Projekti i KF „Drenasi ”, përkrahet me shumën prej **6,000.00€ (gjashtë mijë euro)**, mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve të klubit për vitin 2020.

Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS-së nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe tranfereve, kodi ekonomik 21/611/85001/21200/0000/0820.

Neni 4.

Mjetet financiare barten ne konton e KF „Drenasi”. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga KF „Drenasi”, që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS-në për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5

Për monitorimin dhe zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës së Drenasit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi Komunal i Drenasit si dhe nënshkrimi nga ana e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj